

FJALA E DEPUTETES ERMONELA FELAJ

E ENJTE 21 PRILL 2022

Në lidhje me këtë diskutim, aktet normative nr. 5, datë 12 mars, 2020, dhe akti normativ nr. 8, datë 25.03.2022, sjellin ndryshime në ligjin “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës dhe gazit dhe nënprodukteve të tyre do të doja të bëja në radhë të parë disa konsiderata juridike. Dihet që procesi ligjvënës realizohet nëpërmjet iniciativës ligjvënëse të çdo deputeti, të 20 mijë qytetarëve me të drejtë vote dhe natyrisht edhe të Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave është ai që zë pjesën e “luanit”, ta themi kështu, në iniciativën ligjvënëse dhe kjo është e natyrshme, sepse rrjedh jo vetëm nga e drejta për të qeverisur, por rrjedh edhe nga fakti që vetë Kushtetuta ia përcakton si të drejtë Këshillit të Ministrave të drejtën për të orientuar të gjithë politikën shtetërore në çdo fushë.

Kështu që, edhe në rastin kur qeveria propozon akte ligjore në rrugë normale, por edhe në rastin kur qeveria, sërish bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 101, propozon akte, të cilat kanë fuqinë e ligjit dhe ndërkohë sjellin efekte me kushtëzimin që Kuvendi duhet t’i miratojë brenda 45 ditëve aktet normative që sjell qeveria, do të thotë që jemi para një të drejte të njohur, por edhe të një përgjegjësie që qeveria ka, që në rastin kur i duhet të nxjerrë një akt të tillë me fuqinë e ligjit, sigurisht duhet të ekzistojnë dhe të verifikohen të dyja kushtet që parasheh Kushtetuta në nenin 101 të saj “Nevoja dhe urgjenca”. Besoj se tanimë kjo çështje është kaq shumë e qartë se si ishte situata. Në fakt, ishte situata që e imponoi qeverinë të ndërmerre aktet normative, të cilat lidhen jo vetëm me ligjin për të cilin jemi duke folur, por gjatë ditës së sotme ne do të kemi edhe disa akte të tjera normative, që lidhen edhe me çështje të natyrave të tjera.

Në komisionet parlamentare të dyja këto akte normative janë diskutuar së bashku, sepse janë ndryshime që bëhen në të njëjtin ligj, por përsos kësaj dua të theksoj që Kushtetuta, në radhë të parë, e detyron Kuvendin të mbledhet menjëherë për shqyrtimin e akteve normative, edhe në rastin kur Kuvendi nuk është i mbledhur, detyrohet brenda 5 ditëve të mbledhet. Po ashtu, edhe Rregullorja e Kuvendit parashikon që aktet normative bëhen automatikisht pjesë e programit të Kuvendit të Shqipërisë dhe sipas nenit të veçantë, që bën fjalë për procedura të veçanta që ndjek Kuvendi i Shqipërisë, neni 88, por duhet lexuar edhe neni 86 i Rregullores së Kuvendit “aktet normative shqyrtohen në mbledhjen më të parë të komisioneve përkatëse”. Sidoqoftë, po vij te përmbajtja e këtyre dy akteve. Fatmirësisht, Paketa e Rezistencës Sociale në rastin konkret u parapri nga ngritja e Bordit Kombëtar për Monitorimin e Çmimeve të Hidrokarbureve.

Në gjykimin tim ky ngelet pa dyshim një vendim i duhur jo vetëm për shkak të justifikimit publik që pati dhe ka, por edhe për kujdesin, besoj, që është treguar qoftë në drejtim të qytetarëve, për të cilët ne kemi përgjegjësinë që t’i sigurojmë të gjithë ato mekanizma që bëjnë të mundur mbrojtjen e interesave të tyre, qoftë edhe në drejtim të biznesit. Liritë, të drejtat ekonomike dhe ato sociale parashikohen në Kreun IV të Kushtetutës sonë. Sipas Kushtetutës sonë secili ka të drejtë që t’i fitojë vetë mjetet e jetesës, natyrisht me punë të ligjshme, pra me një punë që çdokush e zgjedh ose e pranon vetë. Por, në fakt, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka edhe një nen tjetër në hyrje të saj, është pikërisht ai nen që

bën fjalë për sistemin ekonomik të Republikës së Shqipërisë. “Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike. Kufizimet e lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike”.

Jua solla në vëmendje këtë, sepse gjatë kësaj kohe, duke u luajtur shumë me populizmin gati-gati është harruar që është në mes edhe një palë tjetër, biznesi, i cili, sipas sistemit të qeverisjes, që vetë e kemi pranuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, është i lirë ta zhvillojë veprimtarinë e vet ekonomike. Ne nuk mund ta përdorim biznesin për t’u lëvduar, për ta promovuar sa herë që në sajë të tij, të mendjes dhe të investimit të tij, vendi përfiton, por sigurisht duhet të jemi të vëmendshëm edhe në qasjen tjetër, në rastin kur me ligj duhet të bëhen kufizime ku në një situatë normale nuk do të kishin asnjë logjikë për t’u kryer dhe asnjë lloj mbështetjeje ligjore. Natyrisht, ka dhe do të ketë gjithmonë individë krijues, ka dhe do të ketë gjithmonë, fatmirësisht, mendje të zgjuara që kanë qëllime të pastra dhe në sajë të këtyre mendjeve, të arsyes dhe të racionalitetit të tyre nuk përfitojnë vetëm ata, por përfitojmë ne të gjithë, përfiton shoqëria, përfiton shteti dhe qytetarët. Për këto arsye unë them që në këtë lloj debati ne duhet të jemi të kujdesshëm.

Mua më vjen mirë që edhe në rastin tjetër, ku do të diskutohet për bordin kombëtar të monitorimit të çmimit të ushqimeve bazë, është parë që bordi të përvijohet si një bord ndërmintor, i cili në përbërjen e tij nuk ka vetëm përfaqësues të institucioneve kryesore qeverisëse, por ka edhe përfaqësues të biznesit, qoftë të biznesit të madh, qoftë të biznesit të vogël. Shteti ka detyrimin të flasë me biznesin, shteti nuk mund të sillet si parazit dhe në rastin që ka nevojë të gjithë ngarkesën t’ia shkarkojë biznesit, sepse ka edhe përgjegjësinë e tij në fushë dhe qasja duhet të jetë e balancuar që të shkojë në favor të qytetarëve, por ama të mbrojtë edhe sipërmarrjen dhe të dyja këto duhen kombinuar. Për këto arsye, kur të dyja këto akte normative janë diskutuar në komisionet parlamentare, kam qenë në mbështetje të tyre si akte që në një kohë të shpejtë kanë operuar për të siguruar pikërisht këtë lloj balance që ne kemi nevojë. Pavarësia, individualizmi, liria politike, liria ekonomike, ambiciet prodhuese, besoj se këto janë ato që duhet të na udhëheqin, dhe dijet tona, në rast se ne duam progresin për Shqipërinë dhe në rast se duam vërtet që Shqipëria të progresojë.

Prandaj, do t’ju lutesha, kolegë, që ne të kishim më shumë sesa një sulm politik ndaj atyre që i bënë, të kishim një vëmendje në përmbajtjen e këtyre akteve, pasi sot pas votës sonë në Kuvendin e Shqipërisë ato marrin fuqinë e ligjit dhe natyrisht do të vazhdojnë të veprojnë si të tilla për një kohë të kufizuar derisa të zgjasë kjo nevojë që kemi. Ndërkohë ju ftoj të adresohemi te përgjegjësia që ne kemi. Përgjegjësia që ne kemi është si i iniciojmë ne instrumentet, të cilat vënë në lëvizje prodhimin. Ne kemi nevojë që ekonominë tonë ta kthejmë drejt prodhimit, kemi nevojë që të kuptojmë se disa asete publike janë aq të rëndësishme saqë duhen ruajtur, sepse në raste të tilla janë ato që bëjnë amortizatorin. Marr shkas edhe nga një diskutim që u bë dje për një marrëveshje huaje për rikonstruksionin e plotë të hidrocentralit të Fierzës. Fatkeqësisht, me kolegët e opozitës nuk patën një mirëkuptim për këtë marrëveshje, prandaj unë mendoj se qasja duhet të jetë e arsyeshme në çdo rast, dhe në momentin kur nga këto lloj qasjesh përfitojnë qytetarët, duhet të jemi të gjithë pro, sepse nuk ka vend për të bërë kundërshti politike. Faleminderit!